

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZONI PENAL, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.M. nga fshati P., Komuna e P., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 297 par. 5 lidhur me par. 1 dhe 3 të KPK-së, sipas aktakuzës së PPQ në Prishtinë - tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.399-5/10 të datës 26.07.2010, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik në praninë e Prokurorit të Shtetit-Basri Morina, të dëmtuarës dhe të akuzuarit, me datë 10.10.2014, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari H. M., me nofkën L., i biri i A. dhe nënës N. e vajzërisë H., i lindur më *data e lindjes...*, me vendbanim në fshatin P., Komuna e P., me nr. personal: *numër personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka të dhëna nëse më parë ka qenë i gjykuar, apo zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptarë-Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim nga data 01.07.2010, deri me datë 22.07.2010.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 01.07.2010, rreth orës 07:40 min, në rrugën e Brigadave, mu përballë ndërtesës së ujësjellësit "Batllava" në Podujevë, gjersa ishte duke drejtuar automjetin e tij "Peugeot" (F) 2 RHY, me targa të regjistrimit *numër i targave...*, duke mos ia përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave në rrugë për shkak se nuk i ka respektuar rregullat e komunikacionit në kundërshtim me nenin 54 të LSKRR, nga pakujdesia duke menduar lehtë se në atë mënyrë nuk do ti rrezikoj pjesëmarrësit tjerë në komunikacion dhe duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes që ka qenë 50km/h, kurse i pandehuri ishte duke zhvilluar shpejtësinë prej 107Km/h, dhe gjersa i pandehuri ndërmerr veprimin e anashkalimit të kombit Mercedes me targa *numër i targave...*, i cili ishte i ndalur pjesërisht në rrugë e godet të ndjerin A.H. i cili kishte zbritur nga automjeti i anashkaluar i tipit Kombi Mercedes me pjesën e përparme të anës së djathtë veturës të cilin e përplasë për kapakun e motorit të automjetit për ta hedhur më pas në erëmbrojtësin e automjetit, pastaj bie në kulmin e automjetit dhe nga aty viktimja përplasë për asfalti ku pëson lëndime të rënda trupore si pasojë e të cilave e humb jetën,

Me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.5 lidhur me par. 1 dhe 3 të KPK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,6,11,16,34,36,38,54,64,73, dhe në bazë të nenit 297 par.5 lidhur me par.1 dhe 3 të KPK-së, si dhe në bazë të nenit 450,453 dhe 365 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

I.Të akuzuarin H. (A.) M., i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej **një (1) viti**, të cilin do ta mbajë pasi aktgjykimi të merr formë të prerë.

II.Në dënimin e shqiptuar të akuzuarit i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. **01.07.2010 deri më dt. 22.07.2010**

III.E dëmtuara K.M. nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

IV.Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën aq sa bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate ndërsa në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej **150€ (njëqindpesëdhjetë/euro)**, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 54 par.2 nën par.5 të KPK-së të akuzuarit H.M. i shqipton edhe,

DËNIMIN PLOTËSUES NDALIM I DREJTIMIT TË AUTOMJETIT

Ashtu që të akuzuarit H.M. i ndalohet drejtimi i automjetit për të gjitha kategoritë në kohëzgjatje prej **një (1) viti**.

Koha e kaluar në mbajtje të dënimin sipas këtij aktgjykimi nuk i llogaritet në kohën e ndalesës për drejtimin e automjetit.

A r s y e t i m

PPQ në Prishtinë - tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP.nr.399-5/10 të datës 26.07.2010, kundër të akuzuarit H.M., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 297 par. 5 lidhur me par. 1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti shqyrtimin gjyqësor në praninë e prokurorit të Shtetit, të dëmtuarës dhe të akuzuarit.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i akuzuari u deklarua i pa fajshëm për veprën penale për të cilën akuzohet.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet në tërësi aktin akuzues meqenëse e njëjta është e bazuar në ligj, dhe kërkoj nga gjykata që t'ia falë besimin ekspertizës të komunikacionit rrugor si dhe dëshmisë së ekspertit dhënë në shqyrtimin gjyqësor, dhe ti shqiptohet një dënim meritor ligjor.

E dëmtuara në fjalën përfundimtare deklaroi sa i përket të akuzuarit theksoi se ia lë gjykatës që të vendosë, ndërsa nuk parashtrroi kërkesë pasurore-juridike.

Gjykata gjatë procedurës se provave ka dëgjuar, të dëmtuarën K. M., dëshmitarin S.M., Ekspertin e Komunikacionit ing.V.D., dhe janë lexuar: Mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit dhënë me datë 13.07.2010, raporti mjekësor i QKMF në Podujevë, me nr.584 të datës 01.07.2010, lidhur me vdekjen e të ndjerit A.S., si dhe fotografitë e vendit të ngjarjes, dhe është dëgjuar mbrojtja e të akuzuarit, të gjitha këto me qëllim të vërtetimit të plot dhe të drejt të gjendjes faktike.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje penale këto prova gjykata konform nenit 8 dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura në shqyrtim gjyqësor që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgegjeje vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dëshmitari S.M. në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash deklaroi se ditën kritike kam qenë duke vozitur kombi-Mercedes pasi që punoj si taksist, me të arritur te ujësjellësi jam ndalur që të zbresin udhëtarët dhe kam vërejtur se i ndjeri A.H. është goditur nga vetura që e drejtonte i akuzuari i cili ka qenë shpejt dhe nuk ka arrit të frenoj para se ta godiste të ndjerin.

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit ing.V.D. të dhënë me datë 13.07.2010 dhe i dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësorë të dt.10.10.2014, vërtetohet se ngasësi i automjetit "Peugeot" me targa *numër i targave...*, tani i akuzuari H.M. ditën e aksidentit ka bërë lëshime primare duke mos respektuar shpejtësinë e lëvizjes në atë pjesë të rrugës në vendbanim ku shpejtësia e lëvizjes ka qenë e kufizuar 50km/h, ndërsa i akuzuari ka qenë me shpejtësi 107 km/h, si dhe duke mos i kushtuar kujdes të duhur këmbësorëve në rrugë me ç'rast godet këmbësorin duke i shkaktuar lëndime vdekjeprurëse, po ashtu sipas ekspertit të komunikacionit aksidentit i ka kontribuar edhe këmbësori i cili ka bërë kalimin (trupimin- e rrugës) para automjetit kombi-Mercedes nga i cili kishte zbritur pa u siguruar se a mund ta bëjë kalimin e rrugës pa i penguar

pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, e që janë lëshime sekondare, po ashtu ka theksuar se në këtë aksident ka mund të ketë ndikuar edhe madhësia apo dimensionet e automjetit kombi-Mercedes i cili mund të ketë pamundësuar ngasësit të automjetit "Peugeot" që me kohë ta vërej këmbësorin.

Nga raporti mjekësor i QKMF në Podujevë, shërbimi i emergjencës me nr. të protokollit 584 të dt.01.09.2010 ,vërtetohet se i ndjeri A.H. në emergjencë është sjellë pa shenja jete, me ç'rast është konstatuar vdekja e tij nga Dr.F. R.Xh..

Nga foto-dokumentacioni në shkresat e lëndës shihet automjeti i cili ka shkaktuar aksident(vetura që ishte duke drejtuar tani i akuzuari),automjeti-kombi nga i cili kishte zbritur tani i ndjeri dhe pjesa e rrugës në vendbanim ku ishte shkaktuar aksidenti me pasoja vdekje.

I akuzuari në fjalën përfundimtare veç tjerash deklaroi se e ndjen veten fajtor pjesërisht për ngjarjen që ka ndodhur, theksoi se më vjen shumë keq që ka ndodhur ky aksident, i kërkoj falje familjes së të ndjerit dhe kërkoj nga gjykata që t'i jap një dënim të kushtëzuar.

Kjo gjykatë nga deklaratat e të akuzuarit vërtetoi se në rrugën ku ishte shkaktuar aksidenti kishte udhëtuar dy herë në javë e kjo do të thotë se për të akuzuarin kjo rrugë ka qenë e njohur dhe në bazë të rregullave të përgjithshme të komunikacionit është dashur ta di se shpejtësia e lëvizjes është e kufizuar në 50 km/h, pasi që është zonë banimi në të dy anët e rrugës me shtëpi-objekte. E që tani i akuzuari ka drejtuar automjetin në atë pjesë të rrugës me një shpejtësi që ishte me shumë se dy (2) herë më e madhe se shpejtësia e lejuar dhe atë në vendbanim (përkatësisht në shpejtësi 107 km/h) nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik e që ka rezultuar me një të vdekur.

Pas administrimit dhe vlerësimit të provave në shqyrtimin gjyqësor gjykata sipas bindjes së lirë vërtetoi gjendjen e plot dhe të drejt faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ju dhënë besimin e plot mendimit dhe konstatimit të ekspertit të komunikacionit, deklaratës së dëshmitarit S.M. e pjesërisht edhe deklaratës së të akuzuarit dhënë në shqyrtimin gjyqësor, e të cilat ndërlidheshin njëra me tjetrën se i akuzuari ditën kritike në rrugën "Brigadat" përball ndërtesës së ujësjellësit "Batllava" në Podujevë, me automjetin e tij "Peugeot" duke zhvilluar shpejtësi prej 107 km/h, ndërmerr veprimin e anashkalimit të tipit Kombi Mercedes, e godet të ndjerin i cili kishte zbritur nga automjeti kombi dhe si pasojë e këtyre lëndimeve të rënda ndërron jetë.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga provat e administruara, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit, i cili nuk ka lëvizur me shpejtësi adekuate e cila i lejon shoferit që të kontrollojë mjetin, në kushte ekzistuese të komunikacionit, posaçërisht duke pasur parasysh pamjen, dukshmërinë e rrugës, ngarkesën e mjetit, kushtet atmosferike dhe dendësinë e komunikacionit në mënyrë që mjetin e vet ta ndal para çdo pengese me çka ka shkel nenin 54 par 1 të LMKRR, e që përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par.5 lidhur me par.1 dhe 3 të KPK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën nga pakujdesia, duke mos i kushtuar vëmendje të mjaftueshme shpejtësisë në vendbanim, për t'iu përshtatur kushteve në rrugë e cila i lejon shoferit të kontrolloj automjetin, për çka edhe është shkaktuar aksidenti.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që gjykata gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjykata e ka analizuar mbrojtjen e të akuzuarit duke gjetur se është e drejtuar nga ikja e përgjegjësisë penale duke e hedhur poshtë si të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara nga të cilat u vërtetua përtej çdo dyshimi gjendja faktike në mënyrë të drejt dhe të plot si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 64 të KPK-së, kështu si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka shpreh keqardhje duke ju kërkuar falje familjes së të ndjerit A.H., pa të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar apo zhvillohet procedurë tjetër penale, rrethanë tjetër lehtësuese gjykata e ka vlerësuar se aksidentit i ka kontribuar edhe i ndjeri, këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit, rrethanë rënduese gjykata gjeti peshën e rëndë të veprës penale të shkaktuar nga veprimet e të akuzuarit, i cili e ka tejkalluar kufizimin e shpejtësisë prej 107 km./h në vendbanim (përkatësisht prej 57 km/h më e madhe se ajo e lejuar në vendbanim), e që ka rezultuar me një të vdekur, andaj duke vlerësuar këto rrethana, gjykata të akuzuarin e gjykoi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti të cilin do ta vuaj pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, dhe duke konsideruar se vetëm me dënim kryesor nuk arrihet qëllimi i dënimit, kjo gjykatë i shqiptoi edhe dënim plotësues ndalimin e drejtimit të automjetit në kohëzgjatje prej një (1) viti për të gjitha kategoritë.

Kërkesën e të akuzuarit që ti shqiptohet një dënim i kushtëzuar gjykata nuk e akceptoi, sepse me dënime të kushtëzuara kur ka humbje jete si pasojë e aksidentit të shkaktuar për shkak të tejkalimit (të dyfishtë) të shpejtësisë së lejuar, nuk arrihet qëllimi i dënimit, e që duhet të ndikoj edhe te tjerët që të përmbahen nga kryerja e veprave të kësaj natyre, nga se kjo gjykatë konsideron se aksidentet e komunikacionit me pasoja fatale në vendin ton janë në rritje dhe dënimet e shqiptuara në këto raste duhet të jenë në proporcion me shkallën e lart të rrezikshmërisë shoqërore të këtyre veprave penale.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të parandaloj nga kryerja e veprave penale, të parapara me nenin 34 të KPK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar është marr në kuptim të nenit 73 par.1 të KPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr në bazë të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.1. dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi dënimin plotësues është marr në bazë të nenit 54 par.2 nën par.5 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZONI PENAL
P.nr.905/13,dt.10.10.2014

Sekretarja Juridike
Mihrie Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.